



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-72

Prishtinë, më 1 korrik 2009, në orën 15:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 1 KORRIK 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Myfera Shinik dhe Slobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjonaj, Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini dhe Xhezair Murati, kurse munguan Lulzim Zeneli dhe Bojan Stojanoviç.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica,

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Sherif Konjufca dhe Selman Ymeri,

Nga NDI-ja, Rinor Beka,

Nga OSBE-ja: Lejla Selimi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe dy (2) pika shtesë.

Kryesia miratoi propozimin e Kryetarit të Kuvendit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 qershor 2009,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 qershor 2009

Xhavit Haliti tha se kur është diskutuar për pikën: Pagat dhe mëditjet për vitin 2009, nuk ka qenë i pranishëm dhe nuk është dashur te komentohen gjërat pa praninë e tij e që i janë referuar qëndrimeve të tij. Ai shtoi se nuk e mbështet vendimin e Kryesisë lidhur me caktimin e pagave dhe të mëditjeve.

Kryesia miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 qershor 2009, me vërejtjet e Xhavit Halitit.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e radhës të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare **vendosi** që seanca plenare e Kuvendit të mbahet **më 9 korrik 2009**, me këtë

R e n d d i t e

1. Fjalimi vjetor i Presidentit të Republikës së Kosovës,

2. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-36 për duhanin,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër korrupsionit,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës,
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët,
14. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës,
15. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës-drejtorit të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina,
16. Shqyrtimi i Letrës së Bardhë: Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë,
17. Njoftim i Grupit Parlamentar të SLS-së lidhur me zëvendësimin e dy anëtarëve në komisionet parlamentare.

3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për procedim të përsheptuar të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, vendosi që ajo të radhitet për seancë plenare më 9 korrik 2009.

3.2 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për shpalljen e hapësirës zonë me interes të veçantë ku do të ndërtohet “Hidrocentrali i Zhurit”.

Kryetari njoftoi të pranishmit me Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për shpalljen e hapësirës - zonë me interes të veçantë ekonomik ku do të ndërtohet “Hidrocentrali i Zhurit”.

Kryesia, pasi shqyrtoi Propozim-vendimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për shpalljen e hapësirës – zonë me interes të veçantë ekonomik ku do të ndërtohet “Hidrocentrali i Zhurit” dhe Kuvendit t’ia paraqesin Raportin me rekomandime.

3.3 Shqyrtimi i propozimit të Grupit Joformal i Grave Deputete lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit zgjedhor

Kryetari njoftoi të pranishmit për propozimin e Grupit Joformal të Grave Deputete, i përkrahur nga grupi i deputetëve, lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-072 për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Kryesisë: **Myfera Shinik, Ibrahim Gashi, Sabri Hamiti, Nexhat Daci, Xhavit Haliti, Naim Maloku** dhe **Eqrem Kryeziu**, ishte vlerësim i përbashkët se ky ligj nuk mund të ndryshohet dhe të plotësohet para zgjedhjeve lokale të këtij viti për shkak të kohës së shkurtër që është në dispozicion.

Kryesia vlerësoi se propozimi i Grupit Joformal të Grave Deputete për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës nuk mund të procedohet para zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009.

3.4 Shqyrtimi kërkesës së Komisionit ad-hoc për lejimin e kompensimit e punës së anëtarëve të tij

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i anëtarëve të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në shumën prej 50 €, ndërsa 30€ për stafin mbështetës të Komisionit, për çdo mbledhje të mbajtur.
2. Kompensimi, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, realizohet sipas evidencës për pjesëmarrje në mbledhje.

3.5 Shqyrtimi kërkesës së Partisë Demokratike të Ashkanlive të Kosovës lidhur me emërimin e Danush Ademit deputet, në emër të kësaj partie,

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Partisë Demokratike të Ashkanlive të Kosovës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk është përgjegjëse për certifikimin dhe caktimin e deputetëve.
2. Partia Demokratike të Ashkanlive të Kosovës mund t'i drejtohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3.6 Njoftimi i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Kryetari informoi Kryesinë me qëndrimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për funksionalizimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kryesia konstatoi që Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare në Kosovë, të nxjerrin përfundimin për fillimin e procedurës për propozimin e kandidatëve të mundshëm për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

3.7 Shqyrtimi kërkesës së deputetëve: Riza Smaka, Drita Kadriu dhe Sadik Idriz për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimit zyrtar i deputetëve: Riza Smaka, Drita Kadriu dhe Sadik Idriz në Bruksel, Belgjikë, në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, prej datës 12 deri më 16 korrik 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit (fjetjen) i bart organizatori, kurse shpenzimet e tjera, si dhe mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

3.8 Njoftimi i Presidentit të Republikës së Kosovës për paraqitjen e fjalës vjetore para Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi njoftimin e cekur më lart, vendosi që kjo pikë të radhitet në seancën plenare të datës 9 korrik 2009, si pikë e parë e rendit të ditës.

3.9 Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Sinavere Rysha për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg të Francës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetes Sinavere Rysha në Strasburg, Francë, në Universitetin Veror për demokraci, prej datës 6 deri më 10 korrik 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurën sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa Kuvendi i Kosovës nuk merr përsipër të mbulojë asnjë shpenzim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën 15:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**